01.	06.01.22	Kërkesë për informacion lidhur me përfitimin e statusit të jetimit për të lindurit jashtë martese.	06.01.22	<p>Statusi i jetimit sipas Ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996, i jepet personave nga mosha 0-25 vjeç, që plotësojnë një nga këto kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>të lindurit jashtë martese;</li><li>personave që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit;</li><li>personave të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton;</li><li>personave që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.</li></ol> <p>Nëse plotësohet kriteri si fëmije jashtë martese duhet të plotësohet dokumentacioni si më poshtë vijon: certifikatë personale, certifikatë familjare, 2 foto të fëmijës si dhe aktin e lindjes të fëmijës. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social ku banon personi.</p>	E plotë	Nuk ka



02.	09.01.22	Kërkesë për informacion lidhur me bankat e tërheqjes së bonusit të bebes dhe afatet.	09.01.22	Bonusi i bebes mund të tërhiqet në çdo bankë Credins në të gjithë Shqipërinë brenda afatit 1 vjeçar të lindjes së foshnjës.	E plotë	Nuk ka
03.	10.01.22	Kërkesë për informacion lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së ndihmës ekonomike për familjet që kanë një anëtarë me AK, si edhe nëse mund të aplikojë për NE një familje që ka një anëtar të saj të punësuar.	12.01.22	<p>Lidhur me mënyrën se si përcaktohet masa e ndihmës ekonomike kur në strukturën e familjes ka anëtar me aftësi të kufizuar (PAK), në VKM-në Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, çdo familje/individ në nevojë gëzojnë të drejtën për të aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike duke respektuar përcaktimet e pikës 12, Kreu III e VKM-së së sipërcituar. Në pikën 12 përcaktohet se: “Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo individ, përfitues i ndihmës ekonomike, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen”.</p> <p>Për sa i përket të drejtës së përfitimit nga skema e ndihmës ekonomike, në VKM-në Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2, gërma (a) përcaktohet se përfitues të ndihmës ekonomike janë: a) familjet në nevojë, që</p>	E plotë	Nuk ka



				nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, si dhe kategoritë e veçanta mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore/bashkisë ku kanë vendbanimin.		
04.	15.01.22	Kërkesë për informacion mbi përfitimin e bonusit të bebes në rastet kur fëmija humb jetën pas lindjes	18.01.22	<p>Në mbështetje të vendimit nr. 288, datë 10.4.2020, në rast kur fëmija ndërron jetë pas lindjes, procedohet sipas pikës 3, Kreu II ku citohet se: “Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi), sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, i jepet prindit/prindërve, menjëherë pas lëshimit të dokumentit “Certifikatë asistencë në lindje”, në përfundim të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile”.</p> <p>Në rastin kur foshnja ndërron jetë pas lindjes, por për të është plotësuar nga ana e institucionit spitalor dokumenti “Certifikatë asistencë në lindje”, prindi/prindërit përfitojnë ndihmën e menjëhershme financiare (bonusin) pasi të kryhet regjistrimi në RKGJC, nga ana e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile dhe të lëshohet dokumenti</p> <p>“Certifikatë nga akti i lindjes” dhe certifikata familjare sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.</p>	E plotë	Nuk ka
05.	23.03.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e fëmijëve që përfitojnë nga skema e aftësisë së kufizuar, NE dhe bonus i bebes për vitin 2022.	23.03.22	<p>1. Fëmijë 0-18 vjec në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike për vitin 2021 është <b>103,675</b> fëmijë (referuar mesatares vjetore të 2-mujoreve për vitin 2021)</p> <p>2. Numri fëmijëve PAK që kanë përfituar për vitin 2021 është <b>15,181</b>.</p>	E plotë	Nuk ka



				<p>3. Lidhur me bonusin e bebes ju sqarojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka lëshuar çeqe për fëmijët e lindur jashtë territorit të Shqipërisë dhe në spitalet private të Shqipërisë. Fëmijët e lindur në spitalet publike e marrin çekun e bebes nga vetë spitali publik.</p> <p>Konkretisht, 19.166 çeqe janë lëshuar për vitin 2021 për fëmijët e lindur jashtë territorit të Shqipërisë dhe në spitalet private brenda territorit të Shqipërisë.</p>		
06.	04.05.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e përfituesve të bonusit të bebeve nga viti 2019 në vijim, të ndarë sipas shumës së bonusit të fituar për fëmijë të parë, të dytë dhe të tretë	06.05.22	Për periudhën Prill 2019-Mars 2022 kanë përfituar bonusin e bebes 39.698 bebe, nga të cilët 14.546 janë përfitues të bonusit si fëmi i parë, 17.078 janë përfitues të bonusit si fëmijë i dytë dhe 7459 janë përfitues të bonuseve si fëmijë i tretë. 645 bonuse janë lëshuar për fëmijët e lindur 2 ose më shumë njëkohësisht (binjakë ose trinjakë).	E plotë	Nuk ka
07.	17.05.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e të moshuarve në vendin tonë, sa prej tyre janë të braktisur, sa është numri i të moshuarve në Shtëpi të Moshuarish etj.	26.05.22	Nuk ka të dhëna statistikore nga SHSSH në lidhje me numrin e të moshuarve në vendin tonë dhe sa prej tyre janë të braktisur. Numri i përfituesve në IPSH është 1466, nga të cilët 323 janë rezidenciale dhe 1143 janë në shërbime ditore. Nuk është përcaktuar një indikator matës për faktorët që çojnë individët të braktisin të moshuarit. Por nga shqyrtimet e dokumentacioneve të të moshuarve dhe nga vlerësimet social-ekonomike të	E plotë	Nuk ka



				<p>çdo të moshuari janë identifikuar arsye të ndryshme që sjellin braktisjen e të moshuarve. Mund të përmendim vështirësitë ekonomike, largimi jashtë vendit i fëmijëve të tyre, pamundësia për t'u kujdesur për ta.</p> <p>Strategjia e përkujdesjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë ka mundësuar ngritjen e strukturave të shërbimit social publik, privat dhe joqeveritar për zbutjen se problemeve sociale që përjetojnë të moshuarit në nevojë, rritjen e cilësisë së shërbimit në institucionet rezidenciale specifike që trajtojnë të moshuarit, përmirësimin e cilësisë së standardeve të shërbimit, trajtimin e tyre në kushte sa më optimal.</p> <p>Qeveria ka hartuar një plan veprimi ku janë parashikuar strategjitë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit “Plani Kombëtar i Veprimit mbi Moshimin 2020 – 2024”.</p>		
08.	23.05.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e grave dhe burrave të moshës 60-69 vjeç që trajtohen me NE.	06.05.22	Kthyer përgjigje se Shërbimi Social Shtetëror nuk i administron këto të dhëna në formë të ndarë sipas moshës dhe gjinisë.	E plotë	Nuk ka
09.	23.05.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e	24.05.22	Sipas viteve, 2019 (44 fëmijë), 2020 (45 fëmijë) dhe 2021 (37 fëmijë).	E plotë	Nuk ka





	<p>fëmijëve që dalin nga IPSH që administrohen nga SHSSH, ku strehohen ata pas daljes nga institucioni dhe a ka politika mbështetjeje shteti për këtë target grup.</p>		<p>Në çdo institucion përkujdesi rezidencial punohet për uljen e kohëqëndrimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale duke u fokusur në ndjekjen e procedurave ligjore për birësimin e tyre, rastet e fëmijëve të braktisur që në lindje ose pa interesim. Gjithashtu për fëmijët me interesim nga familjarë, sektorët social me specialistet punonjës socialë dhe psikologë në çdo institucion rezidencial përkujdesi për fëmijë bashkëpunojnë me strukturat vendore ku ndodhet familja e fëmijës për mbështetjen dhe fuqizimin e saj në mënyrë që fëmijët të rikthehen sa me shpejt në familjet biologjike apo kujdestare. Për fëmijët të cilët rikthimi në familje për shkak dhe rrethana te ndryshme social -ekonomike ka qenë i pamundur bëhet transferimi i tyre në qendrat me shërbim gjysëm të pavarur për mbështetje me programe integruese, nëpërmjet nxitjes së punësimit në të ardhmen.</p> <p>Skemat e mbështetjes janë:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Programet mbështetëse janë më fokus familjen dhe fuqizimin e saj të cilat ofrohen në nivel Bashkie, ku ndodhet familja e fëmijës.</li><li>2. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në çdo Bashki (PMF) monitoron në familje fëmijët pas daljes nga instiucioni si dhe i përfshin ata në</li></ol>	
--	--	--	--	--



				programet e mbrojtjes dhe integritimit.		
10.	09.06.22	Kërkesë për informacion lidhur me shumën e pagesës së NE për familjet që kanë fëmijë trinjakë.	12.06.22	Bazuar në VKM 868 datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime të VKM-597 datë 04.09.2019" Pika 1 e kreut nr.3 gërma a thuhet: "Masa e ndihmës ekonomike në muaj, për prindërit e fëmijëve të lindur trenjakë është 9000 lekë"	E plotë	Nuk ka
11.	09.08.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e familjeve që përfitojnë NE gjatë vitit 2021, të grupmoshës 15-29 vjeç dhe të ndarë sipas gjinisë, si edhe numrin e personave të moshës 15-29 vjeç të cilët marrin shërbime në qendrat e përkujdesit shoqëror dhe numri i personave që marrin pagesë të AK.	11.08.22	Numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2021 është 68,472, ndarë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 62,030 familje në sistemin e pikëzimit,</li> <li>• 4,486 familje në skemën e 6 %,</li> <li>• 1,956 individë që u përkasin kategorive të veçanta.</li> </ul> Nuk kemi të dhëna për ndarjen Femra/Meshkuj. Nuk kemi të dhëna për moshën 15-29 vjeç. Numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2021 është 144,628 persona, nga të cilët: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 71.281 janë persona me aftësi të kufizuar (të verbër, paratetraplegjikë, me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore)</li> <li>• 73,347 janë invalidë pune</li> </ul> Nuk kemi të dhëna të ndara sipas moshës. Numri total i përfituesve të shërbimeve shoqërore për vitin 2021 është 16,027, nga të cilët 9,353 përfitues femra. Numri i përfituesve të shërbimeve shoqërore për të rinj për vitin 2021 është 1,823 nga	E plotë	Nuk ka



				<p>të cilët 947 përfitues femra.</p> <p>Sqarojmë se të dhënat për shërbimet shoqërore për të rinjtë i referohen grupmoshës 18-22 vjeç dhe mbi 22 vjeç. Nuk zotërojmë të dhëna sesa është raporti i të rinjve në krahasim me përfituesit totalë nga skema e mbrojtjes sociale.</p>		
12.	28.09.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e personave përfitues të NE dhe numrin e tyre që i përkasin moshën 30-60 vjeç.	30.09.22	Numri i familjeve/individëve që trajtohen me NE aktualisht është <u>64.000</u> . SHSSH nuk ka të dhëna të ndara sipas grupmoshës.	E plotë	Nuk ka
13.	03.10.22	Kërkesë për informacion lidhur me ndryshimet e pagesave të AK për një grup qytetarësh nga Elbasani.	04.10.22	Deleguar për kompetencë dhe verifikim në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.	E plotë	Nuk ka
14.	07.10.22	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e shtëpive të fëmijës në të gjithë vendin, vendndodhjet, numrin e fëmijëve sipas grupmoshave etj., qëndrimi i SHSSH për raportin e KLSH etj.	14.10.22	<p>Tipologjia e shërbimeve sociale është e përcaktuar në <u>Ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</u>.</p> <p>Institucionet e përkujdesit rezidencial për fëmijë janë shërbime kujdesi afat-gjatë të ndara, në qendra publike me fondet e shtetit dhe jopublike me fondet e donatorëve, organizatavejofitimprurëse.</p>	E plotë	Nuk ka

Institucionetpublike	NR aktual	Gjinia	
		Mashku II	Femer
SHF 0-5 vjeç Tiranë	32	18	14
SHF 0-5 vjeç Korçë	13	8	5
SHF 0-5 vjeç Vlorë	11	3	8
SHF 0-5 vjeç Durrës	17	12	5
SHF 0-5 vjeç Shkodër	17	11	6
SHF 6-15 vjeç Shkodër	18	8	10
SHF 6-15 vjeç Tiranë	37	28	9
SHF 6-15 vjeç Sarandë	32	17	15
SHF 16-18 vjeç Shkodër	19	10	9
<b>Totali</b>	<b>196</b>	<b>115</b>	<b>81</b>

Buxheti i akorduar është si më poshtë:

	Paga	Sigurime	602
SHF 0-5 vjeç Tiranë	24.500.000	4.100.000	12.600.000
SHF 0-5 vjeç Korçë	9.900.000	1.660.000	4.140.000
SHF 0-5 vjeç Vlorë	12.450.000	2.080.000	4.140.000
SHF 0-5 vjeç Durrës	18.600.000	3.180.000	5.400.000
SHF 0-5 vjeç Shkodër	9.350.000	1.730.000	3.960.000
SHF 6-15 vjeç Shkodër	15.000.000	2.510.000	6.570.000
SHF 6-15 vjeç Tiranë	22.000.000	3.680.000	18.500.000
SHF 6-15 vjeç Sarandë	15.170.000	2.670.000	9.000.000
SHF 16- 18 vjeç Shkodër	9.500.000	1.590.000	8.100.000

Qëndrimi i instiucionit është bërë publik menjëherë pas publikimit të raportit të KLSH dhe mund ta aksesoni në link-un:



				<a href="https://www.sherbimisocial.gov.al/reagim-per-shtyp/">https://www.sherbimisocial.gov.al/reagim-per-shtyp/</a>  Për çdo rast dhune të raportuar apo evidentuar nga media, është ndërhyrë nga institucionet përgjegjëse në shqyrtimin e rastit dhe marrjen e masave në përputhje me udhëzimet dhe standardet e shërbimeve të perkujdesit për fëmijë.		
15.	10.10.22	Kërkesë për informacion lidhur me nr. e fëmijëve që kanë përfituar status jetimi për herë të parë për vitin 2021 dhe 2022, sa është numri i jetimëve në të gjithë Shqipërinë.	10.10.22	Për vitin 2021 kanë përfituar status jetimi për herë të parë 150 fëmijë ndërsa për vitin 2022 kanë përfituar status jetimi për herë të parë 102 fëmijë. Nuk kemi të dhëna mbi numrin total të fëmijë jetimë në të gjithë Shqipërinë.  Kjo shifër për vitin 2022 është deri në këtë periudhë sepse deri në fund të vitit do mblidhet edhe njëherë komisioni për shqyrtimin e rasteve të reja.	E plotë	Nuk ka
16.	3.11.22	Kërkesë për informacion lidhur me trajtimin e të moshuarve në vendin tonë, a ka pasur denoncime për dhunë, a ka një kënd ankesash në IPSH, a ka pasur raste dhune në Shqipëri në 2022 dhe si janë trajtuar?	4.11.22	Pranë Shërbimit Social Shtetëror nuk janë referuar ankesa për raste dhune ose keqtrajtimi për të moshuarit që janë të akomoduar në IPSH publike për të moshuar. Në kuadër të procedurave të trajtimit dhe referimit të dhunës në familje janë identifikuar nga kordinatorët vendor të dhunës në Bashki raste të viktimave të dhunes në familje. Shërbimi Social Shtetëror ka ofruar strehimin e rasteve sipas nevojave në qendra të specializuara për trajtimin e viktimave të dhunës në familje.  Nuk ka pasur ankesa nga familjarët në lidhje me	E plotë	Nuk ka



			<p>kujdesin që ofrohet në institucionet rezidenciale për të moshuar.</p> <p>Bazuar ne VKM Nr. 821, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale" të moshuarit që janë të akomoduar në IPSHpublike për të moshuar gëzojnë të gjitha të drejtat ligjore dhe mbrohen nga llojet e ndryshme të abuzimeve. Përfituesit mbrohen nga abuzimet fizike, financiare, materiale, psikologjike dhe seksuale, si dhe nga diskriminimi dhe plagosja e vetes Ankesat e tyre shqyrtohen seriozisht dhe shoqërohen me veprime konkrete. Ne çdo Ipsh publike për të moshuar ekziston një procedurë ankesash e thjeshtë, e qartë dhe transparente, që është e hapur për të gjithë klientët dhe familjarët e tyre, e cila zbatohet në praktikë. Procedura përmban afatet e kthimit të përgjigjes dhe emrat e personave/organeve që do të merren me ankesën. Ka një dokument që sqaron procesin e ankimimeve me një gjuhë të thjeshtë. Përfituesit dhe/ose familjarët kanë firmosur formularin përkatës duke treguar se kanë njohuri për procesin e ankimimit.</p> <p>Në çdo Ipsh për të moshuar ka një kuti ankesash ku të moshuarit mund të raportojnë shqetësimet e tyre në lidhje me cilësinë e shërbimit, marrëdhënien me stafin. Kjo kuti ankesash hapet çdo muaj nga punonjësi përgjegjës i Drejorisë Rajonale të Shërbimit Social në prani të stafit social të institucionit.</p>		
--	--	--	--	--	--



				Pranë Shërbimit Social Shtetëror nuk janë referuar raste dhune ndaj të moshuarve në IPSH publike për të moshuar.		
17.	16.11.22	Kërkesë për informacion lidhur me funksionimin e Qendrës Komunitare për Moshën e Tretë Palasë, arsyet e mos-funksionimit dhe përdorimin e denoncuar nga Policia Vendore Vlorë.	16.11.22	Qendra Komunitare e Moshës së Tretë Palasë është qendër publike në varësi të Shërbimit Social Shtetëror mbështetur mbi VKM nr. 385, datë 06.05.2015 “Për kalimin në përgjegjësi të MMSR të objektit të shkollës 8- vjeçare Palasë” dhe Urdhrit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 323, datë 07.12.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare të Moshës së Tretë Palasë”. Kjo qendër është hapur në vitin 2019 dhe ka funksionuar si një shtëpi pushimi për përfituesit e shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror në Shqipëri. Përfituesit e shërbimeve sociale nga institucionet e përkujdesit në varësi të Shërbimit Social, të shoqëruar nga stafet përkatëse, kanë pushuar me radhë sipas një plani pushimesh verore. Lidhur me këtë qendër, prej fillimit MSHMS ka shprehur gatishmërinë e saj që të përdoret përtej këtij funksioni, edhe si një qendër komunitare. Qendra Komunitare për Moshën e Tretë Palasë është ndërtuar dhe mbulohet me fonde nga buxheti i shtetit sipas përcaktimeve të Urdhrit nr. 323, datë 07.12.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare të Moshës së Tretë Palasë”.	E plotë	Nuk ka



				<p>Prej vitit 2019 ka një buxhet të akorduar nga Shërbimi Social Shtetëror për shpenzime operative dhe shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore.</p> <p>Ky shërbim është ngritur ekskluzivisht për përfituesit e shërbimeve sociale. Nuk është e vërtetë që kjo qendër është shfrytëzuar nga Policia e Shtetit për pushime verore. Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë i ka drejtuar kërkesë Shërbimit Social Shtetëror për shfrytëzimin e ambienteve për 1 muaj, por kjo kërkesë nuk është pranuar nga ana e SHSSH dhe MSHMS.</p>		
--	--	--	--	--	--	--





## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01.	05.01.23	Kërkesë për informacion lidhur numrin e qendrave publike dhe jo publike për fëmijët me AK, pagesat e kujdestarëve të fëmijëve me AK.	06.01.23	<p>Në Shqipëri ka 67 qendra publike/jopublike për qytetarët me nevoja të veçanta. Pagesa që marrin kujdestarët e fëmijëve me nevoja të veçanta rregullohet sipas legjislacionit në fuqi. Konkretisht:</p> <p>Sipas Urdhrit Nr. 222/3, datë 31.08.2022 “Mbi zbatimin e vendimit nr.31, datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga Statusi i Invalidit, Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të ndryshuar, masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit/fëmijës paraplegjikë dhe tetraplegjikë është 12.515 lekë në muaj.</p> <p>Sipas Urdhrit Nr. 222/2, datë 31.08.2022 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të Verbërit, i ndryshuar, masa e përfitimit për kujdestarin e personit/fëmijës me status Verbërie është 13.525 lekë në muaj.</p> <p>Sipas Urdhrit Nr. 222/1, datë 31.08.2022 “Mbi zbatimin e vendimit nr.182, date 26.02.2022, “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe të ndihmësit personal” masa e përfitimit të ndihmësit personal të personit/fëmijës me aftësi të kufizuar është 12.515 lekë në muaj.</p> <p>Sipas Urdhrit Nr. 222/4, datë 31.08.2022 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave , “Për Përcaktimin e Masës, të Kritereve, Proçedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e Aftësisë së Kufizuar të Ndihmësit Personal, dhe të Srukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre ” masat e përfitimit për ndihmësin personal janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Masa e ndihmësit personal të fëmijës për shërbime gjithpërfshirëse është 14.584 lekë në muaj.</li> <li>• Masa e ndihmësit personal të fëmijës për shërbime herëpashershme është 9.723 lekë në muaj.</li> </ul>		
02.	10.01.23	Kërkesë për informacion lidhur me përfitimet e fëmijëve të sëmurë me Fibrozë Kistike.	13.01.23	Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Manualin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Fëmijë, mbështet fëmijët me diagnozën “Fibroze Kistike” me pagesë të aftësisë së kufizuar. Niveli I kufizimeve përcaktohet nga Komisionet Shumë-disiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe intervistën e realizuar më fëmijën dhe prindin.	E plotë	Nuk ka
03.	26.01.23	Kërkesë për informacion lidhur me mbështetjen financiare për të rriturit dhe fëmijët që jetojnë me	26.01.23	Fëmijët dhe të rriturit që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar bazuar në vendimin e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Trajtimi me pagesë bëhet	E plotë	Nuk ka



		HIV/AIDS		mbështetur në komplikimet dhe kufizimet që HIV/AIDS sjell në jetën e personave të infektuar.		
<b>Gjatë muajit Shkurt 2023 nuk ka pasur kërkesa për informacion.</b>						
04.	13.03.23	Kërkesë për informacion lidhur me targat e makinve në pronësi të institucionit SHSSH.	23.03.23	Targat e mjeteve në pronësi të SHSSH janë: AA802DZ AA186KS.	E plotë	Nuk ka
<b>Gjatë muajit Prill 2023 nuk ka pasur kërkesa për informacion</b>						
05.	31.05.23	Kërkesë për informacion lidhur me ndryshimet dhe përfitimet e bonusit të bebes	01.06.23	Ndryshimet ligjore për fëmijët që nuk janë rezidentë në Shqipëri nuk janë publikuar ende në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë mundësia e përfitimit qëndron deri në momentin e publikimit të ndryshimeve. Dokumentacioni për përfitim të bonusit të bebes është: * Certifikatë personale e bebit, me shënimin për bonusin e bebes; * Certifikatë familjare, me shënimin për bonusin e bebes; * Fotokopje e dokumentit të identifikimit të të dy prindërve; * Në rastet kur çeku do të tërhiqet nga një familjar kërkohet pajisja me prokurë të posaçme për tërheqjen e çekut të bebes. Bonusi i bebes tërhiqet derisa fëmija të mbushë 1 vjeç.	E plotë	Nuk ka
06.	07.06.23	Kërkesë për informacion mbi numrin e familjeve rome të akomoduar në QKTE, kohëzgjatjen, riintegrimin, kriteret e akomodimit etj.	12.06.23	Sa familje Rome jane akomoduar ne Qender ? Aktualisht janë akomoduar 21 familje te komunitetit Rom dhe 16 familje qe i perkasin komunitetit Egjiptian. Sa eshte kohezgjatja e qendrimit te tyre dhe si do te riintegrohen ?	E plotë	Nuk ka



			<p>Qëllimi i kësaj qendre është t'ju vijë në ndihmë individëve dhe familjeve në emergjencë që vijnë nga grupe të ndryshme shoqërore pa dallim gjinie, seksi, race, gjuhe, feje etj.</p> <p>Koheqendrimi i këtyre familjeve është me pak se një vit . Qendra ofron mbështetje për t'ju mundësuar përfituesve aksesin tek shërbimet e tjera publike, përshirjen e përfituesve në marrjen e shërbimeve baze si dhe ofrimin e një game të gjere shërbimesh sociale integruese për të drejtuar përfituesit në një jetesë të pavaruar. Qendra punon dhe mbështet përfituesit që të jenë të pavaruar ekonomikisht dhe të sigurojnë një akomodim alternativ.</p> <p>Riintegrimi i këtyre familjeve në komunitet mundësohet nëpërmjet Programeve të Strehimit që ofrohen nga Bashkitë (Bonus qeraje dhe Banese Sociale).</p> <p>3.A ka patur rikonstrukcion të godinave ku ata jetojnë ?</p> <p>Jo nuk ka patur.</p> <p>4.Me çfare kriteresh apo situatë akomodohen familjet në këto godina ?</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Familje të cilat mbeten të pastrehe dhe detyrohen të jetojnë në rrugë</li><li>• Në rast fatkeqesish natyrore kur ju shkatërrohen shtëpitë (psh në rast zjarri )</li><li>• Vlerësim social ekonomikë nga bashkia përkatëse për situatën emergjente të kushteve të jetesës së tij apo të familjes.</li><li>• Të jenë të aftë të shërbejnë vetes dhe</li></ul>		
--	--	--	--	--	--



				familjes ( te sigurojne vete ushqimin dhe higjenen)		
06.	08.06.23	Kërkesë për informacion lidhur me fondet për Shtëpitë e të Moshuarve në Kryeqytet	08.06.23	Fondi për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë është 27.635.000 lekë për vitin 2023. Ndërsa fondi për Qendrën Polivalente Kamëz është 8.130.000 lekë.	E plotë	Nuk ka
07.	13.06.23	Kërkesë për informacion mbi trendin e sistemimeve në IPSH për të moshuar si edhe kohëzgjatjen e qëndrimit.	13.06.23	<p>Për shkak të zhvillimeve sociale dhe demografike ka një rritje të numrit të të moshuarve në nevojë, sistemi i mbrojtjes sociale synon ndërtimin e një rrjeti kompleks shërbimesh sociale publike e private, rezidenciale, komunitare e ditore, shërbim në shtëpi për të moshuar, në mënyrë që të shtohen aktorët që do të ndikojnë në plotësimin e nevojave të të moshuarve.</p> <p>Institucionet e Përkujdesit Social për të Moshuar, ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e integritimit social të tyre. Aktiviteti i institucioneve bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj moshës së tretë.</p> <p>Institucionet e përkujdesit për të moshuar respektojnë standardet e miratuara për ofrimin e përkujdesit social-shëndetësor. Institucionet e përkujdesit social për të moshuar kanë si qëllim ofrimin e shërbimeve sipas parimeve bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• respektimi dhe garantimi i vlerave dhe personalitetit individual</li> <li>• barazia e mundësive</li> <li>• e drejta për te përfituar</li> </ul>	E plotë	Nuk ka



				<ul style="list-style-type: none"> <li>• partneriteti</li> <li>• transparenca dhe paanshmëria</li> <li>• pavarësia, integrim shoqëror dhe pjesmarrje në komunitet</li> <li>• mosdiskriminim</li> </ul> <p>Të moshuar të strehuar në institucione përkujdesi për të moshuar ndër vite janë:  2019-313  2020-363  2021-286  2022-303</p> <p>Kohëqëndrimi i të moshuarve në institucion përkujdesi është afatgjatë. I moshuari zgjedh të qëndrojë në institucion gjatë gjithë kohës ose të kthehet në familje në rastet kur bëhet e mundur. Institucioni ofron shërbim për të moshuarit deri në momentin e fundit që ai/ajo ndërron jetë duke respektuar të gjitha ritet dhe dëshirat e lëna prej tij.</p>		
08.	17.07.23	Kërkesë për informacion mbi numrin e personave me pagesë të AK, ndarjet sipas gjinisë.	17.07.23	Numri mesatar i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2022 , është 70,208 persona. Nuk kemi të dhëna të ndara sipas gjinisë.	E Plotë	Nuk ka
09.	25.08.23	Kërkesë për informacion mbi numrin e përfituesve të kompensimit të energjisë elektrike dhe fondin që shpenzohet për të nga viti 2018-2022 për PAK dhe NE	28.08.23	Fondet sipas viteve janë:  2018 – 334881423 lekë 2019 – 345949966 lekë 2020- 368160652 lekë 2021- 350906857 lekë 2022- 323228588 lekë	E Plotë	Nuk ka



				Viti	Te Verber		Para - Tetraplegjik			
					Numri gjithsej	Me kujdestar	Numri gjithsej	Me kujdestar		
					2018	8,549	2,378	4,345		
2019	8,356	2,371	4,244	4,188						
2020	8,037	2,256	4,113	4,059						
2021	7,792	2,294	3,957	3,929						
2022	7,620	2,159	3,857	3,853						
Viti	Fondi gjithsej i perdorur per kompesimin e fatures se energjise elektrike per perfituesit e PAK		Numri i familjeve ne skemen NE qe perfitojne kompesim per EE							
2018	312,788,968		22,055							
2019	294,540,844		25,262							
2020	329,005,053		24,384							
2021	299,852,243		24,055							
2022	307,052,119		22,468							
10.	26.09.23	Kërkesë për informacion mbi numrin e familjeve që përfitojnë PAK, fondin në dispozicion,		Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 numri total PAK + invalidë punë në të gjithë Shqipërinë është 72.537. Kategoritë që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar janë:					E Plotë	Nuk ka



		kriteret për përfitim etj.	<ul style="list-style-type: none"><li>• Personat me aftësi të kufizuar mendor dhe fizik;</li><li>• Status i Para-Tetraplegjisë</li><li>• Status i Verbërisë</li><li>• Invalidë pune, të cilët komisionohen nga KMCAP-et e ISSH dhe përfitojnë sipas Ligjit nr. 77889, datë 14.12.1994, i ndryshuar. Personave përfitues sipas këtij ligji u jepet nje shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie. Ky fond është pjesë e fondit të Programit të Mbrojtjes Sociale.</li></ul> <p>Nisur nga numri i popullsisë dhe shtrirjes gjeografike, qarku i Tiranës dhe Elbasanit kanë numrin më të lartë të përfituesve të aftësisë së kufizuar.</p> <p><u>Shënim:</u> Të dhënat statistikore janë të publikuara në ëeb-in e Shërbimit Social Shtetëror dhe përditësohen sipas VKM nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë, të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore siedhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”.</p> <p>Lidhur me fondin total për vitin 2023 është në vlerën 18 miliard lekë.</p> <p>Në lidhje me interesimin tuaj mbi rastet e paligjshmërive ju informojmë se Shërbimi Social Shtetëror vlerëson personat me aftësi të kufizuara nga KMCAP e Nivelit të Parë dhe Epror, të cilët</p>		
--	--	----------------------------	--	--	--





				<p>kanë në përbërjen e tyre mjekë specialistë (QSUT, poliklinika të specialiteve etj.) të vendosur si anëtarë të KMCAP-ve me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vlerësimi nga KMCAP-et kryhet në bazë të dokumentacionit mjekësor të lëshuar nga institucionet shëndetësore të nivelit terciar/poliklinika të specialiteteve. Në rastet ku konstatohet që ka mungesë të dokumentacionit apo kërkohen ekzaminime shtesë të përcaktuara nga urdhëri i Ministrit sipas diagnozave përfituese, KMCAP i nivelit të parë e dërgon për rivlerësim në KMCAP Epror.</p> <p>Gjatë periudhave të ndryshme kohore janë ngritur nga MSHMS task forca për kontrollin e dosjeve të personave përfitues të pagesave të aftësisë së kufizuar. Për të gjitha rastet të cilat kanë rezultuar me probleme dokumentacioni janë dërguar për rivlerësim në KMCAP Epror, i cili kërkon pajisjen me konsulta/ekzaminime shtesë (nga institucionet mjekësore diagnostikuese) dhe merr vendim të formës së prerë mbi përfitimin.</p>		
11.	09.10.23	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e familjeve që përfitojnë NE, kriteret, shpërndarjen gjeografike etj.	13.10.23	Bazuar në Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” Neni 7, gërma (a) dhe VKM-në Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2, gërma (a) përcaktohet se përfituesit e ndihmës ekonomike janë: ..... (a) familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të	E Plotë	Nuk ka



			<p>pamjaftueshme”. Nga skema e ndihmës ekonomike trajtohen rreth <u>64 mijë</u> familje/individë në nevojë. Fondi buxhetor mbulon 100% të këtyre familjeve të cilat janë përfituese në skemën e Ndhmës Ekonomike. Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 % e masës së pensionit social dhe e indeksuar.</p> <p>Qytetet, të cilat kanë numrin më të madh të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë Qarku Elbasan, Kukës, Dibër ndjekur nga qarku Korçë, Shkodër.</p> <p>Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” Neni 7, gërma (a) dhe VKM-në Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” përcakton se aplikimi për përfitim nga skema e ndihmës ekonomike kryhet pranë njësisë vendore ku qytetarët kanë vendbanimin. Në pikën 1, të këtij kreu përcaktohet se, për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari/anëtari madhor, së bashku me bashkëshortin/en ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë, duke paraqitur vetëm ID personale. Administratori, në prani të kryefamiljarit/anëtari</p>	
--	--	--	---	--



				<p>madhor, së bashku me bashkëshortin/en ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike.</p> <p>Përzgjedhja e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo refuzimi i tyre kryhet përmes sistemit elektronik, bazuar në kritere që kanë të bëjnë me demografinë e familjes, statusin ekonomiko-social të tyre, grupmoshën, arsimimin dhe historikun e mëparshëm të punësimit të tyre. Deklarimet e bëra nga qytetari në formularin fillestar të aplikimit verifikohen në sistemin e menaxhimit të informacionit për vërtetësinë e tyre.</p> <p>Lidhur me interesimin tuaj për pagesat e aftësisë së kufizuar ju sqarojmë se në Shqipëri po aplikohet vlerësimi Bio-Psiko-Social i Aftësisë së Kufizuar, i cili bazohet me ICD-10 dhe ICF.</p> <p>Personat me aftësi të kufizuar trajtohen me pagesë sipas nivelit të kufizimeve dhe funksionimit dhe mbështeten me shërbime rehabilituese dhe sociale në qarqet dhe bashkitë pranë vendbanimit të tyre.</p>		
12.	16.10.23	Kërkesë për informacion mbi uljen e pagesave të aftësisë së kufizuar	19.10.23	<p>Prej vitit 2019 në Tiranë zbatohet vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar i cili bazohet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit. Personat me aftësi të kufizuar, sipas këtij modeli, trajtohen me pagesë sipas nivelit të kufizimeve dhe funksionimit dhe mbështeten me shërbime rehabilituese dhe sociale (sipas rastit) në të gjitha qarqet e Shqipërisë.</p> <p>Në mbështetje të kësaj reforme, pagesat janë ri-</p>	E plotë	Nuk ka



				klasifikuar nga 2 grupe të mëparshme në 4 grupe në varësi të shkallës së kufizimeve dhe dëmtimit të funksionimit. Komisioni Shumë-Disiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së kufizuar përcakton shkallën e kufizimeve, ndërsa pagesat janë të përcaktuara në Vkm nr. 431, datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave, dhe masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse dhe detyrave të tyre në zonat pilot”										
<b>Gjatë muajit Prill 2023 nuk ka pasur kërkesa për informacion</b>														
13.	05.12.23	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e grave kryefamiljare që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike?	07.12.23	<p>Për periudhën 2021-Tetor 2023</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Gra/Kryefamiljare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021</td> <td>6,391</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>5,580</td> </tr> <tr> <td>Tetor 23</td> <td>5,519</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Gra/Kryefamiljare	2021	6,391	2022	5,580	Tetor 23	5,519	E plotë	Nuk ka
Viti	Gra/Kryefamiljare													
2021	6,391													
2022	5,580													
Tetor 23	5,519													
14.	07.12.23	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e qendrave dhe adresat e qendrave që strehojnë gratë e trafikuar dhe dhunuara.	07.12.23	Qendra për Viktimat e Trafikimit janë 4, ndërsa Qendra për Trajtimin e Viktimave të Dhunës janë 2. Këto qendra janë konfidenciale, për rrjedhojë adresat e tyre nuk mund t’ju vihen në dispozicion.	E plotë	Nuk ka								
15.	19.12.23	Kërkesë për informacion mbi marrëveshjet e nënshkuara me bashkitë për fondin social dhe fondet përkatëse.	28.12.23	<p>Shërbimi Social Shtetëror ka nënshkuar Marrëveshje me 12 Bashki të cilat janë përfituese për fondin Social për vitin 2023 si më poshtë:</p> <p>1- Bashkia Bulqizë me fondin 2,605,000 lekë 2- Bashkia Cërrik me fondin 1,576,974 lekë leke</p>	E plotë	Nuk ka								



				<p>3- Bashkia Fier me fondin 2,383,160 lekë leke 4- Bashkia Gramsh me fondin 2,632,000 lekë 5- Bashkia Kamëz me fondin 4,368,903 lekë 6- Bashkia Klos me fondin 1,938,000 lekë 7- Bashkia Lezhë me fondin 2,201,108 lekë 8- Bashkia Maliq me fondin 1,618,348 lekë 9- Bashkia Pogradec me fondin 944,956 lekë 10- Bashkia Poliçan me fondin 2,653,952 lekë 11- Bashkia Pukë me fondin 1,021,800 lekë 12- Bashkia Selenicë me fondin 1,780,000 lekë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--